VENDIM
Nr. 144, datë 12.3.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29.1.2014 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2014 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr. 185, datë 28.12. 2012 "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

"3.1 Përjashtimisht për punonjësit e kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët merren me anketimet, miratimi i numrit të tyre, përcaktimi i afateve kohore dhe specifikime të tjera bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Financave.".

b) Fjalia e dytë e pikës 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Përjashtimisht për QTTB-të, për punonjësit e SHISH-it (shtëpitë e pushimit) dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit.".

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të institucioneve për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama